

Gazetë javore, letrare, kulturore

NACIONAL


Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Me artisten e mirënjohur të kinemasë
shqiptare Elvira Diamanti

Një yll i përjetshëm i kinemasë

Nga Flamur Bërdëllima

faqe 24



Gjithçka rreth ditës të të dashuruarve

Letërsia dhe brengat e dashurisë

Speciale nga Feride Papelekaj

faqe 3-19



EDITORIAL

Muzeu antishqiptar, i Shkupit

Muzeu i qytetit të Shkupit megjithëse funksionon prej gati 60 vitesh nuk ka të punësuar në hapësirat e tij asnjë shqiptarë. Pas Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001, shqiptarët arritën që të përfshiheshin në një numër të vogël në administratë, ndërsa segmente të shtetit përfshirë edhe një institucion historik-shkencor si Muzeu i Shkupit, ka përjashtuar tërësisht nga punësimi shqiptarët. Vetë drejtori i Muzeut të Shkupit, Jovan Shurbinovski, konfirmoi këto ditë se "nuk kemi asnjë shqiptarë të punësuar," duke shënuar një rast të rrallë në botë ku gati gjysma e popullsisë së një vendi përjashtohet jo vetëm nga ndertimi i koncepteve historike të një shteti, por edhe nga punësimi i thjeshtë. Sllavomakedonasit pak muaj më parë hartuan dhe botuan në mënyrë të njëanshme një Enciklopedi fyese ndaj shqiptarëve, duke konfirmuar kështu frymën përjashtuese dhe poshtuese që ky shtet ka përshtatur historikisht ndaj shqiptarëve etnikë. Futja në këtë Muze e specialistëve shqiptarë dhe e të punësuarve të tjerë, kërkimorë-shkencorë, është e rëndësishme nga fakti se brenda fshihen shumë artefakte dhe dokumente të cilat tregojnë të vërtetat historike për popujt që kanë jetuar në hapsirat e Maqedonisë së sotme. Në këtë muze gjenden (në mos qoshin zhdukur) shumë deshmi që provojnë vazhdimin e iliro-shqiptarëve në trojet ku shtrihet Maqedonia e sotshme, të cilat rrezojnë krejt mitin maqedon të linjës zyrtare të Shkupit, të përvetësimit prej ermit shtetëror, deri tek heroi i Antikitetit i njohur si Aleksandri i Madh. Është krejt e qartë se studjuesit sllavomakedonas kanë fallsifikuar historinë e tyre, duke shkruar deri edhe në

Vijon në faqen 28

Eskluzivizht për "Nacional", poezi të reja të poetit të shquar Ali Podrimja

Podrimja: Esse për dashurinë dhe vdekjen

faqe 7



Lirika dashurie nga: Petraq Risto, Demir Gjergji, Izet Shehu, Bajazit Cahani, Shahzade Visha, Agim Desku, Kujtim Shkreli, Nafi Çegrani, Migena Rama

Në BRENDËSI

Ekspresionizmi gjerman

Studim nga Dr. Martin Mato

faqe 21

Tregime nga: Ivan Bonin Bahri Myftari, Reshat Kripa,

faqe 10-20

Dialog me Shopenhaurin

Esse nga Ramiz Kelmendi

faqe 14-15

Prof. Mujë Rugova

Koment nga Sadri Rexhepi

faqe 24

Proza e Gjekë Marinajt

Kritikë nga Hektor Metani

faqe 22

Skenari ruso-serb 1946

Dossier nga Dr. Ilir Kelmendi

faqe 28

Dita e Pavarësisë së Kosovës

Reportazh nga Lumturi Risvani

faqe 21

"Telegrafi" ecën me kohën

Nga Nazmi Lukaj

faqe 29

Prof. Rexhep Shpendi

Dossier nga shaqir Rexhvelaj

faqe 11



Albanian Refining & Marketing of Oil

PËR HERË TË PARË
EURODIESEL
I STANDARTEVE EUROPIANE

PCALBANIA
Broker Sigurimesh

Aty ku siguria është Art

Përsiatje rreth vëllimit poetik “Lutje në ditën e tetë të javës” të Gjekë Marinajt

Dimensionet e lutjes

Në planetin ku autori krijon, nuk ka statusin e “atomit klandestin”, por dinjitetin dhe krenarinë e djalit të magjishëm shqiptar. Oazi brilant poetik “Lutja” ridimensionon mitin e ndjenjës, e puthos atë pazgjidhshmërisht me shpirtin dhe poezinë shqipe, e kulmos tek retë, tek orakujt, hyjnitë, Zeusi nga ku vinë mesazhet e paqta mbi dhe

Nga Hektor Metani



Një simbol, thirri, si kryebrazdë, për t’u ulur në odën e letrave shqipe, këmbëkryq, poeti Gjekë Marinaj, Lutjen. Simbolika e lutjes, nuk mund të quhet rastisje. Agu i tij poetik, virroku i parë i fjalëve të ngjyrosura, dalë nga një shpirt, nga një palcë e lindur poetike, do të mbëllezin djerimën shpirtërore, ku brumi i gatuar kishte si esencë, lutjen: “Mos më ik larg”.

Lutja, për poetin, si kategori filozofike humane ka lindur “siameze” me njeriun, që në momentin kur mbi tokë u duk qeliza e parë me gjak e limfë. Substrati i saj ishte brenda qelizës, i shkrirë. Nuk mund të ndahen binjakët “siamezë” qoftë me bisturinë më të mprehtë të planetit, as nga mendja më e ndritur kirurgjikale që ka njohur njerëzimi. Veçimi do të ishte fatal. Fataliteti do të sillte, vdekjen, harrimin, largimin, tretjen, hirin, rrugës për ne Had.

Vëllimi poetik: “Lutja” shkrin në njësh, shpirtin, poetin, ndjenjën. Lirika e Selishtës, Marinaj ka palcë, muskuj, është. Ajo është prijëtare, impulsive, rrëfenjëse, magjimadhe, hirwplotë, gjithëmbirëse. Muza Erato, në mos ka fjetur me poetin, kafe, pa tjetër, do të ketë pirë me të.

Që në fillim autori shpjegon pozicionin e tij në hapësirë:

“Lind dhe perëndoj me diellin e planetit kiçele Atmosphericë ime është një shtresë e hollë jetë-vdekje”

Nga ç’sallone planetesh vinë këto fjalë, nga ç’humnera, hone, gremina të rrëpirta, të ndriçuara gjysmërisht? Vendjeta, vendvarri i autorit është aty, ku qielli prek horizontin dhe dielli jeton agoninë e vet. Agoni ethesh, ngjethesh. Gjysma e dheut errësohet, natësohet, gjysma lind, dritësohet, çapitet. Njw diell është. Po. Dhe i vetëm. Nata romantike, mbresëlënëse, dita gaztore, shpresëdhënëse. Ç’kane me tepër përrallat?! Kush nuk do ta dëshironte këtë mbrekulli?! Nga kjo pikë hapësinore, fjala i bie këmbanës: “Urrej nga afër efektet e çdo prelude për pushim; Shkatërrimin e njerit, si mundësi e qetësisë së tjetrit”

Dhe më tej me vargun, dashuror, dëshiror, lutës, që thelbësisht është një përmasë e re e padimensiontë, humane e vatrës shpirtërore të prush-

ëzuar:

“Të jem shërbëtor në parajsë, sesa sundues në ferr”

“Autoportret i avancuar”

Planeti letrar i Marina-jt, nuk cënon kërkënd, askujt, nuk ia zw, hostenin e diellit qw i takon, përkundrazi, dashurisht u jep tw gjithëve. Shpirti dhe vargu Marinaj, është natyror, i larë, i xhamtë, i paqtë, i qëruar, pa ngricë e akullsirë, sepse dhe ndjenjat e tij janë, testament, amanet, tokësoro-qiellore, të patretshme, stërplanetare. I lodhur poeti duke pritur “vdekjen imagjinare” nën mbikqyrjen e paqes, vetëm në letër, rreth ballancës së rrezikshme: dashuri-vdekje, lëshon metaforën:

“Shpirtin, Për llambat e qyteteve të tretura, Do ma bësh neon”

Lutja! Ç’vdekje fisnike! Shpirti. Llampa. Neoni. Të ndriçojnë materjen e tretur, tek guri i varrit i një qyteti. Ç’është ky varr që nxë një qytet?! Të llatarshme përmasat e vargut, e pafundme thellësia e mendimit, të cunamta ndjenjat.

“Do të nderoj frikshëm, Përsosmërinë e drejtësisë hyjnore”. (Bisedë me vdekjen).

Bindje drejtësisë hyjnore, të natyrshmes, të pakthyeshmes, lutje për të vdekurin, vdekjen, nderim materjes, ku shpirti, fjala hyjnore e poetit është e pafuqishme ta tjetërsojë, transformojë, sipas dëshirës së vet. Thanatosi, mbretëria e natës, e vdekjes është e vetmja, mirëfilli, që s’pranon, peshqesh, dhurata, para. Ç’të bësh? Ditë-nata. Shkak-pasoja. Mokrat.

Dita e tetë e javës, në tespiet e kalendarit tokë, kurrëkund nuk është rreshtuar. Ajo s’ka vrimë, që të shkohet në çikom, nuk ka emër, substrat kohor, datë, status. Ndoshta, ndoshta, për një farë takëmi gjallesash, quhet “lajthitje”, “vidhisje”, “shkarje ledhi”. Gjithsesi, për “çakërdisjen” e poetit për në planete të tjerë, ku “xhindet letrare” e ngrej në avadan është e gjithëgjendshme. Ajo është shkruar me gërma shkëlqimtare, të djellta në kalendarin hyjnor. Vetë Zeusi, kur jepte drejtësinë mbi dhe pyeste “të shkalluarit”, “të xhindosurit”, “të çakërdisurit” këtë lloj “mostre ëngjellore”. Dita e tetë është syhapja mëngjesore, është trokitja e sekondës, minutës, orës, ditës, javës, muajit, vitit, shekullit.

Manteli veshës i kësaj dite është i ajërt, mjeti komunikues fjala. Fjala e parë Lutja:

“Kafshët të zbuten të bëhen humane Humanët ëngjëj, ëngjëjt poetë.

Poetët të shkrihen, të bëhen poezi” (Lutjet e së djelës).

Një oaz i vërtetë poetik. Relieve të spikatura vlerash. Impresione shkulumesh, liriko-meditative. Përgjegjësi metaforike mitike. Poezia. Fjala. Hyjnorja. Digjet:

“E njelmëta e lotit të njeriut dhe Zotit Me shumë se një grusht flakë për Feniksin”

Martirizohet ndjenja, poeti, poezia. Kush tjetër veçan tyre mund ta bëjë sublimen? Një trup i shpirtëruar, një shpirt i trupëzuar. Një grusht flakë. Përallori Feniks. Pupëlshkëlqyeri. I pafati. Si nuk u gjet një zogëz e sojit bukuror, që fatkobi, të linte rasatin e tij mbi dhe? La ta ndriçojë ëndrrën e tij, flaka e shpirtit të zbardhur der në shpirt.

Një çahir bjeshke në Qershor, ku lulnaja përkund belin magjik, i buzëqesh jetës, diellit, erëmon ndjenjat, ku kroi rrjedh duke qeshur i malluar, është

mozaiku i vargut Marinaj. Lirika dashurore e poetit është e pafundme në thellësi, e pamatë në gjerësi, e paarritshme në lartësi.

“Faqet e tua – dy qiej të përflakur


Dashuria u fshikullon njerëzve në vesh”

“Qiej të përflakur”

Krahasimi planetar, kërkon ndihmën e fishkëllimës, zhangonit më të vjetër dashurak, moshëthinjur sa planeti, për të realizuar mjeshhtërisht ngrehinën poetike. Më tej shpallet siguria:

“Në mos vdeksh për të

Do vdesësh prej saj” (Dashuria).



Ëmbëlsisht poeti me fjalë të gdhëndura, me penën halë pishe, ngjyer në botën, dettrazuar, ekonomitar në sintaksë, po kurrësesi në mendim, gjetje, fabul, shpall përjetshmërinë:

“Ti je e përjetshme Dhe une i pavdekshëm”. (Dusitës).

Aksioma e pavdekësisë. Poetët shuhën, treten, fälën duke i dhënë shumëkujt, prej shpirtit të tyre hyjnor dhe e harxhojnë gjallshëm vdekjen, por para se të treten, fisnikërisht falënderojnë: “Faleminderit... Trëndafil im...!” në natyrë, natyrshëm, natyrisht.

Edeni poetik: Lutja është e ndarë në ngastra, pa kufij të përcaktuar, kohorë, hapësinorë, strukturorë, sintaksorë, tematikë. Çdo ngastër ka poezi të vetëtimta, të dritësuar si gurëmargaritës. Çdo varg mban mbi supë, një barrë mall, një detlotë, një maisje plage. Autori e ka lëshuar “frerin e grinjës” deri sa ajo të bjerë në çarkun poetik: E para nëna! Ara që rrit jetën, e xhevahirta:

“Mozaik hallesh, Duart e saj prej shenjtji”

Sa thjesht dhe bukur, pa kurëfarë hiperbole. Duart e nënës porte, ku vaporët e vuajtjeve, ndalen për të kaluar natën. Dhe krahasimi i përdorur nuk është çalanok, sakat. Një mall i mjerëgulluar trishtueshëm në lotë.

“Ajo është tepër e re që të vdesë E tepër e lodhur që të rrojë” (Në ditëlindjen e nënës).

Fjala tepër është dhimbja e dhimbjes. Identiteti i poetit, në dheun e mbetur, nën thonjtë e gishtave prindërorë. Përmasa ndërplanetare merr figura e nënës në vargjet:

“Shqeu lëkurën e trupit të saj Për të arnuar me të plagët e të tjerëve” (Gonxhe Bojaxhi).

I pazëshëm ky veprim i nënës Terezë. Ç’humanizëm! Ç’mi! Ajo dha gjithshka, kur s’kishte asgjë për të dhënë. Nënës dhe vetëm nënat. Nositi dhe vetëm Nositi i “Shën Llazarit” shqeyjnë kraharorin për bijtë.

Evokimi i disa prej figurave të përbotshme të letërsisë, nuk mund ti shpëtojë shqisës telepatike të profesorit të letërsisë, në fakultetin e Dallasit. Homeri. Dantja tre katësh. Neruda. Getja. Po tanët? Fishta. Migjeni. Reshpja. Titanike figura e Fishtës, jashtëtokësore dhimbja e Migjenit, ndërsa Reshpjes:

“Vetëm vdekja ja njohu vlerat e vërteta poetit Mushkritë- lundra me vela të ngrira drejt njohjes” (Sot u lind Frederik Reshpja).

Në planetin ku autori krijon, nuk ka statusin e “atomit klandestin”, por dinjitetin dhe krenarinë e djalit të magjishëm shqiptar. Oazi brilant poetik “Lutja” ridimensionon mitin e ndjenjës, e puthos atë pazgjidhshmërisht me shpirtin dhe poezinë shqipe, e kulmos tek retë, tek orakujt, hyjnitë, Zeusi nga ku vinë mesazhet e paqta mbi dhe.